



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/42;
Datë: 27.03.2015 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-004-2881	2	28.04.2015

Në bazë të nenit 11 paragrafi 2. të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Ligji Nr. 03/L-204, GZRK numër 88/2010); nenit 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22.1 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.03.2015, nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të
Plotësim - ndryshimeve të

Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016

- I. Me këtë vendim fillohet plotësim - ndryshimi i **Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016** /në tekstin e mëtejme plotësim - ndryshimet/.
- II. Qëllimi i hartimit të plotësim - ndryshimeve të rregullores, sipas këtij vendimi është:
 - a) menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën dhe futja e të dhënave në bazën qendrore;
 - b) vlerësimi i pronës;
 - c) vjelja dhe vjelja e detyruar e tatimit mbi pronën;
 - d) ankesat administrative; dhe
 - e) përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit.
- III. Bartëse e hartimit të plotësim - ndryshimeve të rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.
- IV. Bartësja e hartimit të plotësim - ndryshimeve të rregullores është e obliguar që hartimin e plotësim - ndryshimeve të rregullores ta bëjë në afat prej 5 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e plotësim - ndryshimeve të rregullores nga pika I. e këtij vendimi.
- VI. Plotësim - ndryshimet e rregullores duhet të vihen në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e plotësim - ndryshimeve të rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit të plotësim - ndryshimeve të rregullores ato i procedohen Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

VIII. Mjetet financiare për hartimin e plotësim – ndryshimeve të rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj

kryesues

